

AKT - THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE
"Global Trade Express" SH.P.K

Tirane me 19.09.2023

Neni 1- FORMIMI

Themelohet Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "Global Trade Ekspres" Sh.p.k me Ortake z. Klajdi Shopi dhe z. Hysni Llanaj.

Neni 2 - SELIA

Shoqëria Tregtare "Global Trade Ekspres" Sh.p.k. e ka selinë në: Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, P. 31, Kati 3.

Neni 3 - KOHEZGJATJA

Shoqëria Tregtare "Global Trade Ekspres" Sh.p.k. ka një kohezgjatje të veprimtarisë së saj ekonomike me afat të pacaktuar.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka si objekt veprimtarie:

- Import/Eksport/Stokim produktesh jo-ushqimore.
- Shitje në internet me shumice dhe pakice për tregun shqiptarë të çfaredo lloj produkti jo-ushqimore sipas konceptit Marketplace.
- Transport i mallrave brenda Shqipërisë.
- Marketing online dhe shërbime të tjera marketingu, Telemarketing, Tele-shitje,
- Shërbime dhe Konsulencë në fushën e informatikës,
- Programim në gjuhë të ndryshme programimi,
- Programim faqesh interneti dhe mirëmbajtje të tyre.

Shoqëria gjithashtu mund të kryejë, direkt dhe indirekt, të gjitha aktivitetet që përfshihen në objektin e saj si dhe të gjitha aktivitetet plotësuese që lidhen me të; të ndërmarrë të gjitha operacionet tregtare, industriale, ato që lidhen me pasuritë e tundshme, ato të patundshme dhe pasuritë financiare që lidhen me objektin e vetë shoqërisë. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me ndalimet, kufizimet, kushtet dhe autorizimet e parashikuara në ligj dhe në Statut.

Neni 5 - KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelues i Shoqërisë Tregtare "Global Trade Ekspres" Sh.p.k është 100 leke (njëqind), i cili do të shlyhet i gjithi nga Ortaket e Shoqërisë. Kapitali përbehet nga 2 kuota.

Neni 6 - Administratoret

Shoqëria Tregtare "Global Trade Ekspres" Sh.p.k. ka si Administratore të saj:

- z. Hysni Llanaj, shtetas shqiptar, i biri i Yllit, lindur me 27.10.1986, në Elbasan dhe banues në Elbasan, Rr. Vasil Taja; Nd. 43; H. 1; madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit me nr. personal I61027056E

Administratoret mund të japin dorëheqjen ose të revokohen nga shumica e ortakeve në çdo moment.


Administratoret do të ushtrojnë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e shoqërisë.

Neni 7- SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e Shoqërisë Tregtare "Global Trade Ekspres" Sh.p.k. mund të vijë në çdo kohë dhe për çfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kriterëve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

ORTAKE TE SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Global Trade Ekspres" shpk

Hysni Llanaj



Klajdi Shopi

